



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës Arbnesha Kuqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës	
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Trim Berisha, Zv Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 13.12.2021 Nr.020-948
Zyrtaret përgjegjës:	Gëzim Sahiti, Zv. Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor		
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Prishtinës	
Lloji i aktit:	☐ Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim i Kuvendit të Komunës 01 Nr. 011/11-37189 për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa i Kuvendit të Komunës së Gjakovës

I miratuar më datë: 10.12.2021

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 10.12.2021

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim
1.	Vendim 01 Nr. 011/11-37189 për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa i Kuvendit të Komunës së Gjakovës	Vendim 01 Nr. 011/11-37189 për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa i Kuvendit të Komunës së Gjakovës, i miratuar me datë 13.12.2021 nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës nuk është në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore si dhe me Udhëzimin Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë. <i>Në nenin 6, paragrafët 7 dhe 8, të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, parashihet se:</i> “Organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore në të gjitha nivelet, si dhe institucionet tjera publike, janë të obliguara të miratojnë dhe zbatojnë masa të veçanta për të arritur përfaqësimin e gjinisë më pak të përfaqësuar, deri në arritjen e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve sipas këtij ligji. Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse”.

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, kërkon nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës së Gjakovës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministartstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za :	Ardian Gjini, gradonačelnik Opštine Đakovica Arbnesha Kuqi, predsedavajuća Skupštine opštine Đakovica	
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a Trim Berisha, zamenik generalnog sekretara MALS-a	
Od:	Besim Myrtezani, zamenik rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština/ MALS	Dana, 13.22.2021. Br.020-948
Odgovorni službenici:		
1. Službenik za utvrđivanje pravne procene:	Gëzim Sahiti, zamenik rukovodioca Odseka za monitorisanje opština	
2. Službenik- ca za izradu pravne procene:	Vjosa Ahmetaj, viša službenica za monitorisanje opština	
Predmet:	Zahtev za reviziju zakonitosti akta opštine Đakovica	
Vrsta akta:	☐ Odluka Skupštine opštine	

Uvaženi gradonačelnice,
Uvažena predsedavajuća,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.06/2021 o dopuni i izmeni Uredbe VRK-a br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, utvrđenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br.02/2021 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstva, Pravno odeljenje i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine, kao što je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka Skupštine opštine 01 br. 011/11-37189 o uspostavljanju Odbora za politiku i finansije Skupštine opštine Đakovica
Usvojena dana, 13.12.2021.
Predložena na razmatranje u MALS-u, dana, 13.12.2021.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt u suprotnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

U nastavku možete naći neslaganja opštinskog akta koji je dostavljen za razmatranje zakonitosti:

Br.	Formuliranje u opštinskom aktu	Zakonska odredba sa kojom je opštinski akt u suprotnosti.
1.	Odluka Skupštine opštine 01 br. 011/11-37189 o uspostavljanju odbora za politiku i finansije Skupštine opštine Đakovica	Odluka Skupštine opštine 01 br. 011/11-37189 o uspostavljanju odbora za politiku i finansije Skupštine opštine Đakovica, usvojena dana, 13.12.2021 od Skupštine opštine Đakovica nije u skladu sa Zakonom br. 05/L-020 o rodnoj ravnopravnosti kao i sa Administrativnim uputstvom MALS-a br. 05/2020 o postupcima uspostavljanja, sastavu i nadležnosti stalnih i drugih odbora u opštini. <i>U članu 6. stav 7. i 8. Zakona br. 05/L-020 o ravnopravnosti polova, predviđa da: „Zakonodavni, izvršni i sudski organi na svim nivoima, kao i druge javne institucije, dužni su da donesu i sprovede posebne mere za ostvarivanje zastupljenosti najmanje zastupljenog pola, do ravnopravne zastupljenost žena i muškaraca ostvaruje se ovim zakonom.</i> Ravnopravna zastupljenost polova u svim zakonodavnim, izvršnim i sudskim organima i drugim javnim institucijama postiže se kada je se obezbeđuje minimalna zastupljenost od pedeset posto (50%) za svaki pol, uključujući i njihove organe upravljanja i odlučivanja”.

Na osnovu gore navedenog, Ministarstvo administracije lokalne samouprave *traži* od Skupštine opštine i gradonačelnika opštine Đakovica da preduzmu konkretne mere kako bi akt opštine uskladili sa zakonskim odredbama na snazi, u roku od 30 dana od dana prijema zahteva za reviziju akta.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakvo objašnjenje u vezi sa ovom procenom.